

Vendim nr. 221 datë 07.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 07.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **KOZETA TILI**, përfaqësuar me prokurë nga avokate Arjola Sheri Abdyli.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-258, datë 11.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 23, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (*ligji nr. 152/2013*); vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionet disiplinore në shërbimin civil”; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Kozeta Tili (*kërkuesja*) ka qenë e punësuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në detyrën e “Inspektores së dytë”, prej vitit 2010, ndërsa me vendimin nr. 14, datë 10.01.2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (*DPT*), ajo është konfirmuar me statusin e nëpunësit civil. Gjatë vazhdimit të marrëdhënies së shërbimit civil, me shkresën nr. 1669/1, datë 30.01.2014, DPT-ja ka njoftuar kërkuesen për fillimin e ecurisë disiplinore bazuar në propozimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ndërsa për të është propozuar masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për shkeljen e moszbatimit të dispozitave ligjore në përmbushje të detyrës funksionale. Në përfundim të procedurës disiplinore, Komisioni i Disiplinës (*KD*) pranë DPT-së, me vendimin nr. 1068, datë 23.06.2014 (*vendimi nr. 1068/2014*), ka vendosur dhënien ndaj kërkueses të masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për shkeljen disiplinore të mospërmbushjes së rëndë të detyrave funksionale.

2. Duke mos qenë dakord me masën disiplinore, kërkuesja në vijim ka paraqitur në gjykatë një kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e vendimit për dhënien e masës disiplinore, rikthimin në detyrë dhe pagimin e plotë të pagës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7795, datë 26.12.2014, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 1068/2014 të KD-së pranë DPT-së dhe detyrimin e kësaj të fundit të rikthejë kërkuesen në detyrën që ka pasur, duke i paguar pagën e plotë nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare e në vijim, me arsyetimin se KD-ja ka vepruar në shkelje të plotë të dispozitave ligjore në lidhje me procedurën e shqyrtimit të ecurisë disiplinore për sa i përket së drejtës së njoftimit dhe pjesëmarrjes së kërkueses në procedimin disiplinor. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala e paditur, DPT-ja.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 926, datë 02.03.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkueses, me arsyetimin se pala e paditur, DPT-ja, ka respektuar procedurën ligjore për marrjen e masës disiplinore ndaj kërkueses dhe se kjo masë është në përputhje me ligjin. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka bërë rekurs kërkuesja.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-258, datë 11.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar,

ndërkohë që shkaqet e tij janë të njëjta në përmbajtje me pretendimet/prapësimet në gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel, të cilave u është dhënë përgjigje përfundimtare nga Gjykata Administrative e Apelit.

5. Në datën 01.08.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në datën 02.08.2024.

II

Pretendimet e kërkueses

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:
- 6.1 *E drejta e aksesit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhej të zgjidhte çështjen në themel duke interpretuar ligjin e zbatueshëm në lidhje me mungesën e kërkueses në procedimin disiplinor përpara KD-së, për shkak se ka qenë me raport paaftësie në punë. Duke vendosur mospranimin e rekursit, Kolegji Administrativ ka vepruar në shkelje të legjislacionit në fuqi, pasi akti administrativ për largimin e saj nga puna është nxjerrë në shkelje të rregullave procedurale.
- 6.2 *E drejta e mbrojtjes, e drejta për t'u dëgjuar dhe parimi i barazisë së armëve*, pasi gjatë gjyimit në shkallë të parë është provuar se kërkuesja nuk është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj, duke iu mohuar e drejta për të paraqitur prova dhe për të kundërshtuar veprimet e vendimet e organeve të administratës shtetërore. Ajo është larguar nga shërbimi civil pa pasur dijeni për datën dhe orën e mbledhjes së KD-së, për rrjedhojë nuk ka pasur mundësi të përfaqësohej, qoftë edhe nëpërmjet një mbrojtësi, ndërsa ka qenë me raport mjekësor. Gjykata e apelit ka shtrembëruar faktet dhe provat, pasi nuk ka asnjë provë që të vërtetojë se kërkuesja është lajmëruar për t'u paraqitur përpara KD-së, me përfaqësues, në pamundësinë fizike të saj.
- 6.3 *E drejta e informimit*, pasi kërkuesja nuk është informuar për provat mbi të cilat është marrë masa disiplinore për shkeljen e pretenduar, ndërsa urdhri, i cili ka shërbyer si bazë për fillimin dhe zhvillimin e procesit disiplinor, nuk ka të bëjë me mosrealizimin e detyrave funksionale ditore të ngritura në akuzë. Duke mos përcaktuar të dhënat e sakta të urdhrit të punës, i padituri ka shkelur një nga të drejtat bazë të procedurës, atë të së drejtës së informimit të nëpunësit civil për shkeljen e pretenduar.

- 6.4 *Parimi i sigurisë juridike dhe i barazisë përpara ligjit*, pasi përmes mospranimit të rekursit, Kolegji Administrativ ka legjitimuar vendimin e gjykatës së apelit, e cila nuk ka zbatuar ligjin dhe e ka interpretuar atë dhe faktet çështjes në favor të palës së paditur. Po ashtu, gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses, si edhe nuk ka zhvilluar një proces të rregullt, duke mos ua nënshtruar provat dhe faktet një hetimi të plotë e të gjithanshëm.
- 6.5 *Parimi i proporcionalitetit*, pasi masa disiplinore e marrë nuk është në raport të drejtë me shkeljen, ndërsa vendimi i KD-së është rezultat i interpretimit të gabuar të dispozitave të ligjit nr. 152/2013 në raport me provat dhe faktet. KD-ja duhet të merrte në konsideratë përcaktimet e neneve 57-60 të ligjit nr. 152/2013. Po ashtu, veprimet apo mosveprimet e kërkueses nuk përbëjnë shkelje ose shkelje të rëndë të ligjit. Nga DPT-ja nuk është faktuar pasoja e rëndë e ardhur, si dhe as shkalla e fajësisë e kërkueses.
- 6.6 *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është i arsytuar në drejtim të shkaqeve, rrethanave dhe fakteve mbi të cilat është bazuar vendimmarrja e tij. Ai kolegji nuk i ka dhënë përgjigje asnjë prej pretendimeve të ngritura në rekursin e kërkueses.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në këtë këndvështrim, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, vërehet se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i përket legjitimitit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja ka përfunduar me vendimin nr. 00-2024-258, datë 11.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 01.08.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra pas 7-muajve. Nga komunikimi elektronik i datës 04.09.2024, Gjykata e Lartë ka konfirmuar se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesja është publikuar në faqen e saj zyrtare, duke u bërë i disponueshëm për palët, në datën 19.02.2024, datë nga e cila deri në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual kanë kaluar më shumë se 5 muaj.

12. Në lidhje me këtë fakt, kërkuesja ka argumentuar se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, pasi asaj nuk i është njoftuar vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për të cilin ka marrë dijeni kur është paraqitur personalisht në sekretarinë e asaj gjykate për të tërhequr një kopje të tij.

13. Kolegji vëren se kërkuesja nuk ka ngritur asnjë pretendim në ankimin kushtetues lidhur me mungesën e njoftimit të vendimit të Gjykatës së Lartë në adresën elektronike të saj ose të mbrojtësit të zgjedhur, ndërkohë që nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi nuk rezulton që ata të kenë lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se për shqyrtimin e çështjes së kërkueses në dhomën e këshillimit të datës 11.01.2024 është bërë njoftim në datën 22.12.2023. Në vijim, në datën 11.01.2024 në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë është publikuar edhe informacioni për mënyrën e përfundimit të çështjeve administrative në dhomën e këshillimit të kësaj date, përfshirë dhe çështjen e kërkueses.

14. Ndërkohë, Kolegji vëren, po ashtu, se në ankimin e saj kushtetues kërkuesja nuk ngre pretendime për pamundësinë e saj për t'u informuar për gjendjen në të cilën ndodhej shqyrtimi i çështjes së saj në Gjykatën e Lartë. Për sa kohë ajo ka qenë në dijeni të faktit se çështja, mbi rekursin e saj, ndodhej për gjykim në Gjykatën e Lartë, kërkuesja ka pasur mundësi, por edhe detyrimin për t'u kujdesur për ndjekjen e fatit të çështjes. Pretendimi i kërkueses në lidhje me momentin e marrjes dijeni (ajo vetë ose mbrojtësi i saj) për vendimin e kundërshtuar, në mungesë të argumenteve dhe provave lidhur me pamundësinë e marrjes dijeni për vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë nga momenti kur ai ka qenë i disponueshëm për palët, nuk është i mjaftueshëm për të provuar në nivel kushtetues se data e pretenduar prej saj duhet të konsiderohet si data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e kundërshtuar. Në vlerësimin e Kolegjit, paraqitja e vendimit gjyqësor me shënimin e datës kur është tërhequr nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht prej kërkueses, sepse një shënim i tillë mund të vendoset nga sekretaria gjyqësore në çdo rast dhe në çdo ditë që një palë ndërgjyqëse paraqitet për të tërhequr kopje të vendimit gjyqësor.

15. Për sa më lart, duke analizuar argumentet e paraqitura nga kërkuesja në raport me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji evidenton se ajo nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme nga data në të cilën vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, moment nga i cili fillon afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkueses është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, ajo nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues dhe, për këtë arsye nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kriterëve të tjera të pranueshmërisë së kërkesës.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesja nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "ç", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.